



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E
TË DHËNAVE PERSONALE

DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E HETIMIT SEKTORIAL DHE SIGURISË SË TË DHËNAVE

Nr.1990 Prot.

Tiranë, më 02.09.2024

REKOMANDIM

Nr. 08, datë 02.09.2024

MBI

RESPEKTIMIN E DETYRIMEVE LIGJORE NË KUADËR
TË MBROJTJES SË TË DHËNAVE PERSONALE
NË QENDRAT SHËNDETËSORE DHE QENDRAT E SPECIALITETEVE

Në mbështetje të neneve 29, 30, 31, pika 1 germa a/1, dhe 32 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar (në vijim “Ligji”), në kuadër të mbikëqyrjes së aktivitetit të Kontrolluesve në institucionet e kujdesit shëndetësor parësor (në vijim “Qendrat Shëndetësore, Qendrat e Specialiteteve/Kontrolluesit”), në përmbushje të detyrimeve ligjore në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale me qëllim mbikëqyrjen, si dhe sensibilizimin e këtij sektori,

KONSTATOVA SE:

Në zbatim të Ligjit, Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim “Zyra e Komisionerit”), është angazhuar në kryerjen e hetimeve administrative për mbikëqyrjen e proceseve përpunuese në disa prej Kontrolluesve të Institucioneve të Kujdesit Shëndetësor Parësor (qendrat shëndetësore dhe qendrat e specialiteteve), me qëllim verifikimin e respektimit të detyrimeve që rrjedhin nga Ligji.

Monitorimi i proceseve përpunuese të të dhënave personale të Kontrolluesve në institucionet e Kujdesit Shëndetësor Parësor ka rëndësi nisur nga veçoria e këtyre të dhënave, por edhe si rezultat i digjitalizimit dhe ofrimit të shërbimeve në sistemin e kujdesit shëndetësor. Si rezultat, përmbushja e detyrimeve ligjore sipas përcaktimeve të legjislacionit specifik, ka sjellë dhe nevojën për një vëmendje të shtuar nga ana e Zyrës së Komisionerit, në kuadër të garantimit të përpunimit të ligjshëm, sigurisë, ruajtjes së konfidencialitetit dhe respektimit të parimeve për përpunimin e ligjshëm të të dhënave mbi garantimin e të drejtave të subjekteve të të dhënave personale.

Të dhënat shëndetësore konsiderohen të dhëna sensitive në kuptim të pikës 4 të nenit 3 të Ligjit, për të cilat kontrolluesit duhet të marrin masa shtesë teknike dhe organizative në kuadër të përpunimit të sigurt të tyre. Ruajtja e privatësisë dhe konfidencialitetit të të dhënave personale është një nga të drejtat e parashikuara edhe në Kartën Shqiptare të të Drejtave të Pacientit.

Gjithashtu, marrja e masave shtesë teknike dhe organizative për mbrojtjen e të dhënave personale konsiderohen të domosdoshme për të ruajtur besimin e subjekteve të të dhënave gjatë përpunimit dhe njëkohësisht do të ndihmojnë sistemet e kujdesit shëndetësor të sigurojnë mbështetjen publike në ofrimin e shërbimeve.

Ndërkohë, krahas dispozitave të sipërpërmendura të Ligjit, hetimet administrative janë bazuar në parashikimet e akteve nënligjore të tjera, të nxjerra nga Zyra e Komisionerit në zbatim të Ligjit dhe më specifikisht, Udhëzimi nr. 47, datë 14.09.2018 të Komisionerit *“Për përcaktimin e rregullave për ruajtjen e sigurisë së të dhënave personale të përpunuara nga subjektet përpunuese të mëdha”* (në vijim *“Udhëzimi nr. 47”*) dhe Udhëzimi nr. 49, datë 02.03.2020 *“Për mbrojtjen e të dhënave shëndetësore”* (në vijim *“Udhëzimi nr. 49”*).

Gjatë veprimtarisë monitoruese, Zyra e Komisionerit, ka konstatuar disa problematika në lidhje me zbatimin e detyrimeve të Ligjit nga Kontrolluesit, kryesisht në lidhje me ligjshmërinë e përpunimit, masat teknike e organizative, sigurinë dhe ruajtjen e konfidencialitetit të të dhënave personale të subjekteve të të dhënave, gjatë ushtrimit të aktivitetit të tyre.

Problematikat e konstatuara gjatë hetimeve administrative të ushtruara pranë këtyre Kontrolluesve, gjenden të argumentuara në vijim:

1. Kontrolluesit janë institucione të kujdesit shëndetësor me financim publik, jofitimprurës, në varësi të Operatorit të Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor dhe Njësiave Vendore të Kujdesit Shëndetësor ku shtrijnë veprimtarinë e tyre, të cilat ofrojnë shërbime të kujdesit shëndetësor parësor. Qendrat shëndetësore e ushtrojnë aktivitetin e tyre, në zbatim të ligjit nr. 10107, datë 30.03.2009, *“Për kujdesin shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”*, i ndryshuar, ligjin nr. 123, datë 25.09.2014, *“Për Urdhrin e Mjekëve në Republikën e Shqipërisë”*, Urdhrin nr. 413, datë 13.07.2022 të Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale *“Për miratimin e statutit të qendrës shëndetësore”*.

Në kuadër të veprimtarisë që kryejnë, Kontrolluesit përpunojnë të dhëna personale për kategoritë, *“pacientë”*, *“personel mjekësor”*, *“punonjës të administratës”*, *“vizitorë”*, etj. Përpunimi i këtyre të dhënave kryhet në mënyrë manuale dhe elektronike.

2. Staf i mjekësor i Kontrolluesve administron sistemin e “Regjistrimit elektronik për formularët e vizitave të mjekut të familjes” apo “Portali i mjekut të familjes”, sistemi i cili monitorohet nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

Sistemi “Portali i mjekut të familjes”, ose i quajtur ndryshe regjistri elektronik për formularët e vizitave (e-vizita) të mjekut të familjes, nëpërmjet të cilit operatorët (mjekë dhe infermierë) regjistrojnë vizitat e pacientëve.

Kategoritë e të dhënave të pacientit, që plotësohen automatikisht përmes ndërveprimeve të sistemit e-vizita me Regjistrin e të Siguruarve (AHIS) dhe Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile për identifikimin e pacientit, janë: “Emri”, “Atësia”, “Mbiemri”, “Datëlindja”, “Gjinia”, “Gjendja civile”, “Kodi i Pacientit”, “Sigurimi”, etj.

Operatorët regjistrojnë dy lloje formularësh:

- Formularin e vizitave (mjek specialist, mjek konsultori, vaksinator, infermier/mami etj.);
- Formulari i procedurave mjekësore (infermier: në rastet e mjekimit të plagëve apo injeksioneve të zgjatura në kohë).

Përdoruesit e sistemit mund të logohen në këtë sistem sipas modelit “Single Sign-On” (SSO) përmes ndërveprimit në portalin “e-Albania”, me qëllim identifikimin e përdoruesve të portalit të Mjekut të Familjes, nëpërmjet llogarisë personale. Më pas, përdoruesit mund të aksesojnë ndërfaqen e sistemit “Portali i mjekut të familjes”, sipas specialiteteve të tyre.

3. Rezulton se, Kontrolluesit nuk disponojnë rregullore “Për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale”, por dhe në ato raste që e disponojnë i referohen modelit “tip” të publikuar në faqen zyrtare të Zyrës së Komisionerit. Nga shqyrtimi i tyre konstatohet se, përmbajtja është e kufizuar dhe nuk reflekton përgjegjësitë ligjore, sipas kategorive specifike të të dhënave personale që përpunojnë Kontrolluesit, proceseve përpunuese të tyre, në referim të parimeve ligjore dhe rregullave specifike të parashikuara, në kundërshtim me parashikimet e nenit 27 të Ligjit.

Zyra e Komisionerit vlerëson se, hartimi i një Rregullore specifike “Për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale”, në të cilën të parashikohen rregulla dhe procedura organizative specifike mbi mënyrën e përpunimit të të dhënave personale (për çdo kategori subjektësh), sigurinë e të dhënave, konfidencialitetin, afatet e mbajtjes së të dhënave, etj., por edhe akteve të tjera të brendshme të cilat parashikojnë masa teknike dhe organizative për procese të ndryshme përpunuese, konsiderohen shumë të rëndësishme, në zbatim të nenit 27 të Ligjit, pasi shmang pasojat e rënda që mund të vijnë për subjektet e të dhënave personale.

Zyra e Komisionerit vlerëson se, në mbështetje të parimeve dhe kritereve për përpunimin e të dhënave personale sensitive, si dhe referuar legjislacionit specifik, Kontrolluesit duhet të përfshijnë në aktet e tyre rregullatore të drejtat e pacientëve (e drejta për dhënien e pëlqimit, informimin, privatësia dhe konfidencialiteti, aksesit), në mbështetje të neneve 5 dhe 7 të Ligjit.

Qendrat Shëndetësore grumbullojnë në arkivin fizik dokumentacionin për pacientët dhe punonjësit administrativ. Nga analizimi i Rregullores së Brendshme dhe Rregullores për Mbrojtjen e të Dhënave Personale rezulton se, nuk kanë parashikuar afate konkrete lidhur me kohën e ruajtjes së të dhënave personale për dokumentacionin që administrojnë në funksion të veprimtarisë që ushtrojnë. Të dhënat e mbledhura nga Kontrolluesi ruhen, pa përcaktuar një afat konkret të ruajtjes së tyre, në kundërshtim me gjuhën “d” të pikës 1, të nenit 5 të Ligjit dhe të Udhëzimit nr. 49, datë 02.03.2020 “Për mbrojtjen e të dhënave personale shëndetësore” (në vijim “Udhëzimi nr. 49”).

Ndërkohë, në nenin 9, pika 4 e ligjit nr. 10107, datë 30.03.2009 “Për kujdesin shëndetësor në RSH”, parashikohet se ministri përgjegjës përcakton me urdhër rregulloren për mënyrën e organizimit dhe funksionimit të institucioneve të kujdesit shëndetësor parësor. Në zbatim të pushtetit diskrecionar, ministri përgjegjës me urdhrin nr. 413, datë 13.07.2022 “Për miratimin e statutit të qendrës shëndetësore” ka miratuar modelin tip të rregullores. Nga analizimi i rregullores së sipërcituar, rezulton se në përmbajtje të saj mungojnë dispozita që parashikojnë afatet e ruajtjes së dokumentacionit të administruar në arkivin fizik pranë qendrave shëndetësore.

Megjithatë, Zyra e Komisionerit vlerëson se, lidhur me kategoritë e të dhënave të grumbulluara në funksion të ushtrimit të veprimtarisë së tyre, Qendrat Shëndetësore/Kontrolluesit duhet të parashikojnë mbajtjen e të dhënave personale të grumbulluara në atë formë, që lejon identifikimin për një kohë të caktuar, por jo më tepër se sa është e nevojshme për të përmbushur qëllimin për të cilin të dhënat janë grumbulluar. Koha e ruajtjes së të dhënave personale duhet të përcaktohet nga Kontrolluesi, në përputhje me parashikimin e gjuhës “d”, të pikës 1, të nenit 5 të Ligjit, por jo më tepër se sa është e nevojshme për të përmbushur qëllimin për të cilin të dhënat janë grumbulluar.

Në momentin e përfundimit të qëllimit të përpunimit, Kontrolluesi duhet të realizojë anonimizimin, arkivimin ose shkatërrimin e këtyre të dhënave, në bazë të specifikave që kontrolluesit i përcaktojnë sipas parashikimeve të legjislacionit të posaçëm në ndërveprim me parashikimet e legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale. Megjithatë, në çdo rast ky proces duhet të realizohet pa cenuar vijueshmërinë e përpunimit të të dhënave personale në funksion të sigurimit të kujdesit shëndetësor të vazhdueshëm për qytetarët.

4. Në disa raste, Kontrolluesit nuk aplikojnë “*Deklaratë Konfidencialiteti*” me punëmarrësit, të cilët kanë akses në mbledhjen, përpunimin dhe ruajtjen e të dhënave personale, në kundërshtim me parashikimet e nenit 28 të Ligjit.

Zyra e Komisionerit vlerëson se, qëllimi i nënshkrimit të “*Deklaratës së Konfidencialitetit*”, është që të gjithë punonjësit të cilët kanë akses në të dhënat personale, të kuptojnë qartë dhe drejtë detyrimet që ata kanë mbi përpunimin e të dhënave personale dhe ruajtjen e konfidencialitetit. Në aktin formal me titull “*Deklaratë Konfidencialiteti*”, dalë në zbatim të Vendimit nr. 6 të Komisionerit, datë 05.08.2013 “*Për përcaktimin e rregullave të hollësishme për sigurinë e të dhënave personale*” (në vijim “*Vendimi nr. 6*”), punëmarrësit informohen mbi përgjegjësitë në rast përhapje në mënyrë abuzive të të dhënave personale tek personat e paautorizuar.

Zyra e Komisionerit thekson se, nevojitet një angazhim serioz i Kontrolluesve, me qëllim përmbushjen e detyrimit ligjor për informimin e subjekteve të të dhënave personale, si dhe garantimin dhe respektimin e të drejtave të tyre, në lidhje me marrjen e masave tekniko-organizative për sigurinë dhe konfidencialitetin e të dhënave personale, në përputhje me Ligjin dhe Udhëzimet nr. 3, 4, 47 të Komisionerit, si dhe Vendimin Nr. 6 të Komisionerit.

Plotësimi i këtyre detyrimeve nga ana e Kontrolluesve të këtij sektori është shumë i rëndësishëm, pasi garanton përpunimin e ligjshëm, sigurinë e të dhënave personale dhe shmang mundësinë e përhapjes së tyre në mënyrë të paligjshme.

5. Kontrolluesit disponojnë sistem video-survejimi CCTV, për mbikëqyrjen e ambienteve të brendshme dhe të jashtme të tyre, për qëllim të sigurisë së personelit, pacientëve dhe pronës.

Nga verifikimet në terren, ka rezultuar se disa nga Kontrolluesit nuk disponojnë tabelë informuese për mbikëqyrjen e ambienteve me sistemin CCTV, dhe në ato raste që e disponojnë, tabela nuk është sipas modelit standard, në kundërshtim me parashikimet e nenit 18 të Ligjit dhe Udhëzimit nr. 3, datë 05.03.2010 të Komisionerit “*Mbi përpunimin e të dhënave personale me sistemin e video-survejimit në ndërtesa dhe mjedise të tjera*”, i ndryshuar (në vijim “*Udhëzimi nr. 3*”).

Zyra e Komisionerit vlerëson se, informimi i subjekteve të të dhënave personale mbi prezencën e sistemit të video-survejimit (CCTV) është një nga detyrimet bazë të Kontrolluesit, pasi u jep mundësinë subjekteve të të dhënave personale të njihen me të drejtat që gëzojnë dhe mundësinë e ushtrimit të tyre në praktikë.

Për më tepër, sipas parashikimeve të Udhëzimit nr. 3 të Komisionerit, subjektet e të dhënave duhet të informohen qartësisht që një sistem video regjistrimi është në veprim, duke vendosur njoftimin e shkruar në hapësirën e monitoruar. Gjithashtu, Kontrolluesi detyrohet të vendosë në ambientet e survejuara modelin standard të

tabelës informuese për mbikëqyrjen me sistemin e survejimit të miratuar nga Komisioneri.

Zyra e Komisionerit vlerëson se, lidhur me këtë proces përpunues, Kontrolluesit nuk kanë miratuar rregulla/politika të brendshme specifike për mënyrën e përpunimit të të dhënave personale nëpërmjet sistemit të video-survejjimit CCTV, në kundërshtim me parashikimet e nenit 27 të Ligjit, si dhe Udhëzimit nr. 3.

6. Konstatohet se, disa Qendra Shëndetësore kanë lidhur kontratë/marrëveshje shërbimi me palë të treta me objekt montimin dhe mirëmbajtjen e sistemit të video-survejjimit (CCTV) që disponojnë.

Nga shqyrtimi i përmbajtjes së këtyre kontratave/marrëveshjeve, ka rezultuar se, Kontrolluesit nuk kanë parashikuar dispozita, në të cilat të përcaktohen detyrimet e palëve mbi përpunimin e të dhënave personale, në zbatim të parashikimeve të nenit 20 të Ligjit dhe Udhëzimit nr. 19, datë 03.08.2012 të Komisionerit *“Mbi rregullimin e marrëdhënieve mes kontrolluesit dhe përpunuesit në rastet e delegimit të përpunimit të të dhënave dhe përdorimin e një kontrate tip në rastet e këtij delegimi”*, i ndryshuar (në vijim *“Udhëzimi nr. 19”*).

Zyra e Komisionerit vlerëson se, të gjitha detyrimet e sanksionuara në nenin 20 të Ligjit dhe Udhëzimit nr. 19, duhet të jenë të përfshira në kontratën dhe/ose aneks kontratën e hartuar dhe nënshkruar mes kontrolluesit dhe përpunuesit. Çdo kontratë përpunimi (*outsourcing*), që ka për qëllim delegimin e përpunimit të të dhënave personale duhet të përmbajë dispozita që vendosin rregulla për përpunimin e të dhënave personale, sipas legjislacionit në fuqi. Çdo kontratë e tillë duhet të parashikojë masat që duhet të marrë përpunuesi për të siguruar/garantuar mbrojtjen e mjaftueshme të të dhënave, si dhe hapat që do të ndërmerren në rast cenimi të të dhënave, me qëllim që të sigurojë paprekshmërinë e tyre, në çdo hallkë të këtij përpunimi.

7. Konstatohet se Qendrat Shëndetësore nuk kanë ndërmarrë masa konkrete në kuadër të trajnimit të punonjësve mjekësorë dhe administrativ, që kanë akses dhe përpunojnë të dhëna personale, lidhur me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale, në zbatim të nenit 27 të Ligjit dhe Udhëzimit nr. 47, datë 14.09.2018 të Komisionerit *“Për përcaktimin e rregullave për ruajtjen e sigurisë së të dhënave të përpunuara nga subjektet përpunuese të mëdha”* (në vijim *“Udhëzimi nr. 47”*).

Trajnimet në lidhje me mbrojtjen e të dhënave personale duhet të jenë të vazhdueshme dhe të përshtatura sipas nevojave dhe proceseve të punës së Kontrolluesit dhe legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale, me qëllim ndërjegjësimin e punonjësve të cilët për shkak të proceseve të punës, janë të ngarkuar për përpunimin e të dhënave personale.

PËR KËTO ARSYE:

Në zbatim të neneve 5, 7, 18, 20, 21, 22, 27, 28, 29, 30, 31 (pika 1, germa “a/1”), si dhe 32 të Ligjit,

REKOMANDOJ:

1. Kontrolluesit, të kenë në vëmendje përpunimin e të dhënave personale, në përputhje me dispozitat e parashikuara në Kreun II të Ligjit;
2. Kontrolluesit, të marrin masa për përcaktimin e afateve kohore për ruajtjen e të dhënave, për të gjitha proceset e përpunimit, në përputhje me germën “d”, të pikës 1, të nenit 5 të Ligjit;
3. Kontrolluesit, të marrin masa për zbatimin e detyrimeve, në lidhje me informimin e plotë të subjekteve të të dhënave, sipas parashikimeve të nenit 18 të Ligjit;
4. Kontrolluesit, të marrin masa për të rishikuar marrëveshjet e bashkëpunimit, duke specifikuar detyrimet midis palëve, sipas dispozitave të parashikuara në nenin 20 të Ligjit dhe Udhëzimin nr. 19 të Komisionerit;
5. Kontrolluesit, në zbatim të nenit 27 të Ligjit, të marrin masa për të hartuar Rregullore specifike “Për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale”, duke parashikuar masa konkrete teknike dhe organizative për mbrojtjen e të dhënave personale, për çdo kategori të dhënash dhe për çdo proces përpunimi, mënyrat e përpunimit të të dhënave, të drejtat e subjekteve të të dhënave, etj.;
6. Kontrolluesit, në zbatim të nenit 28 të Ligjit, të marrin masa të aplikojnë “Deklaratën e konfidencialitetit” me punëmarrësit të cilët kanë akses në mbledhjen, përpunimin dhe ruajtjen e të dhënave personale;
7. Kontrolluesit, me qëllim garantimin e sigurisë së të dhënave personale duhet të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në Udhëzimin nr. 47, lidhur me trajnimin e punonjësve që kanë akses dhe përpunojnë të dhëna personale;
8. Operatori i Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor dhe Njësitë Vendore të Kujdesit Shëndetësor, në cilësinë e autoriteteve përgjegjëse për organizimin e punës për menaxhimin, monitorimin ndjekjen dhe raportimin e institucioneve të kujdesit shëndetësor parësor (qendrat shëndetësore dhe qendrat e specialiteteve) lidhur me veprimtarinë e tyre, në respektim të detyrimeve që burojnë nga aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, të marrin masa që në bashkëpunim me strukturat e tyre të varësisë, të zbatojnë të gjithë detyrimet që rrjedhin nga Ligji;

9. Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, në cilësinë e autoritetit përgjegjës për mbikëqyrjen e veprimtarisë së përgjithshme të sistemit shëndetësor dhe Operatori i Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor, në cilësinë e autoritetit përgjegjës për organizimin e punës për menaxhimin, monitorimin ndjekjen dhe raportimin e institucioneve të kujdesit shëndetësor parësor, duhet të marrin masa për të dërguar drejt të gjithë Kontrolluesve, detyrimet rekomanduese të dala nga ky akt i Komisionerit dhe për zbatimin e tyre brenda afatit kohor 180 (njëqind e tetëdhjetë) ditë, duke filluar nga data e marrjes dijeni të këtij akti;
10. Në rast mospërbushje të këtyre detyrimeve, Komisioneri vepron sipas nenit 30, pika 2 e ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “*Për mbrojtjen e të dhënave personale*”, i ndryshuar. Komisioneri në rast shkeljesh serioze, të përsëritura ose të qëllimshme të Ligjit nga një kontrollues ose përpunues, veçanërisht në rastet e përsëritura të moszbatimit të rekomandimeve të tij, vendos sanksion me gjobë për kundërvajtjet administrative dhe e denoncon publikisht ose e raporton çështjen në Kuvend dhe në Këshillin e Ministrave.

Ky Rekomandim u shpall sot, më 02.09.2024.

KOMISIONERI

Besnik Dervishi